



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
KOMISIONI DISIPLINOR

V E N D I M

Nr. 3, datë 20.7.2022

Komisioni Disiplinor i Përmbarduesve Gjyqësorë Privatë, i konstituuar më datë **10.2.2021** dhe i përbërë nga:

Vangjel Kosta
Tedi Malaveci
Erind Mërkuri

Kryetar
Anëtar
Anëtar

mori në shqyrtim kërkesën me nr. {...} prot., datë {...} të Ministrisë së Drejtësisë, për nisjen e procedimit disiplinor ndaj përmbarduesit gjyqësor privat {...} {...}.

Kërkesa bazohej në gjetje ndaj veprimtarisë së përmbarduesit {...} {...}, të marra në analizë nisur nga një numër i konsiderueshëm ankesash, që çuan në nxjerrjen nga ministri i Drejtësisë të:

- Urdhrit nr. {...}, datë {...} “Për hetim disiplinor për përmbarduesin gjyqësor privat z. {...} {...}”;
- Urdhrit nr. {...}, datë {...} “Për nisjen e procedimit disiplinor për përmbarduesin gjyqësor privat z. {...} {...}”.

Nëpërmjet urdhrit nr. {...}, datë {...} të ministrit të Drejtësisë, Komisionit Disiplinor të Përmbarduesve Gjyqësorë Privatë iu përcoll shkresa “Për nisjen e procedimit disiplinor për përmbarduesin gjyqësor privat z. {...} {...}”, raporti i përpiluar pas hetimit disiplinor, kryer nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, bashkëlidhur të cilit dhe dokumentacioni i dosjes hetimore.

Referuar kërkesës dhe gjetjeve të pasqyruara në raport, motivacioni ligjor mbi të cilin bazohet kërkesa për nisjen e procedimit disiplinor, referon në përcaktimet e pikës 1 të nenit 71 të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbardimor gjyqësor privat”.

Komisioni Disiplinor e zhvilloi veprimtarinë e tij bazuar në ligjin nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbardimor gjyqësor privat” dhe urdhrin nr. 189, datë 22.6.2020 të ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e rregullores për konstituimin, organizimin, funksionimin dhe shpërblimin e anëtarëve të komisionit disiplinor të përmbarduesve gjyqësorë privatë”, duke respektuar dhe siguruar të drejtat e përmbarduesit, si dhe duke zbatuar me rigorozitet parimet e hetimit administrativ, me qëllim vlerësimin e kërkesës dërguar për shqyrtim nga ministri i Drejtësisë.

Kërkesa me nr. prot. {...}, datë {...}, për nisjen e procedimit disiplinor dhe vetë raporti që shoqëronte kërkesën, i është njoftuar paraprakisht përmbauesit {...} {...} në datën 4.7.2022, me shkresën nr. {...} prot., “Njoftim për paraqitje në seancë dëgjimore”, si dhe nëpërmjet njoftimit elektronik në adresën elektronike zyrtare të vetëdeklaruar pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë, duke i bërë me dije njëherësh zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 14.7.2022.

I. Konflikti i interesit.

1. Të tre anëtarët e Komisionit, në fillim të procesit, deklaruan se nuk ishin para ndonjë pengese ligjore për shqyrtimin e procedimit disiplinor, nuk ndodheshin në kushtet e konfliktit të interesit dhe/ose nuk kishin asnjë pengesë ligjore për shqyrtimin e plotë, në mënyrë të paanshme dhe objektive të këtij procedimi.

II. Baza ligjore e vendimmarrjes.

1. Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë (Parimet e përgjithshme dhe hetimi administrativ);
2. Ligji nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbauesor gjyqësor privat”;
3. Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë;
4. Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë;
5. Udhëzimi i përbashkët nr. 385/7, datë 28.6.2017 i ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbauesor gjyqësor privat”;
6. Udhëzimi nr. 137, datë 27.4.2020 i ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e rregullave të hollësishme për dokumentacionin dhe procedurën e shqyrtimit të kërkesës për pezullimin e përkohshëm”;
7. Urdhri nr. 4321/4, datë 18.7.2017 i ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e modelit të kontratës që lidhet midis shoqërisë përmbauese/përmbauesit gjyqësor privat dhe palës së interesuar përpara fillimit të procedurave të ekzekutimit”;
8. Urdhri nr. 136, datë 27.4.2020 i ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e Kodit të Etikës së Përmbauesve Gjyqësorë Privatë”;
9. Urdhri nr. 189, datë 22.6.2020 i ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e rregullores për konstituimin, organizimin, funksionimin dhe shpërblimin e anëtarëve të komisionit disiplinor të përmbauesve gjyqësorë privatë”;
10. Urdhri nr. 7317, datë 7.11.2016 i ministrit të Drejtësisë “Për pajisjen, mbajtjen dhe plotësimin e regjistrit të çështjeve përmbauese”;
11. Urdhri nr. 219, datë 17.7.2020 i ministrit të Drejtësisë “Për krijimin, mbajtjen dhe administrimin e arkivit nga përmbauesi gjyqësor privat”.

III. Mbledhjet e komisionit disiplinor, qëndrime dhe komunikime në procesin disiplinor.

1. Me shkresën nr. {...} prot., datë 4.7.2022, me lëndë “Njoftim për paraqitje në seancë dëgjimore”, Kryetari i Komisionit Disiplinor, njoftoi përmbauesin gjyqësor privat {...} {...} për t’u paraqitur në seancën dëgjimore, planifikuar për t’u zhvilluar më datë 14.7.2022. Përmes këtij njoftimi, përmbauesit iu përcoll:

-Shkresë nr. {...} prot., datë {...} “Për nisjen e procedimit disiplinor për përmbauesin gjyqësor privat z. {...} {...}” e Ministrisë së Drejtësisë;

- Urdhër nr. {....}, datë {....} (nr. {....} prot.) i ministrit të Drejtësisë “Për nisjen e procedimit disiplinor për përmbaruesin gjyqësor privat {....} {....}”;
- Raport nr. {....} prot., datë {....} “Për kryerjen e hetimit disiplinor pranë përmbaruesit gjyqësor privat {....} {....}” (14 fletë).

Gjithashtu, përmbaruesit {....} {....} iu bë me dije e drejta për:

- të marrë pjesë në seancën dëgjimore personalisht dhe/ose i përfaqësuar, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative;
- të paraqitur parashtrësia me shkrim brenda datës së caktuar për seancën dëgjimore;
- të paraqitur dokumente dhe/ose të thërritur dëshmitarë, që mund të dëshmojnë fakte me interes për procedimin disiplinor, si dhe nëse do ta konsideronte të nevojshme, të ndërmerre çdo iniciativë apo masë për paraqitjen e provave, të dhënave ose dokumenteve që do i shërbenin në seancën dëgjimore.

1.1 Ky njoftim iu përcoll në rrugë shkresore (shkresa nr. {....} prot., datë 4.7.2022) dhe në rrugë elektronike, në datën 5.7.2022, ora 12:28, nga adresa dhomakombetarepermbarimit@gmail.com, në adresën {....} dhe {....}, adresa zyrtare të vetëdeklaruar nga përmbaruesi gjyqësor privat {....} {....}.

2. Komisioni Disiplinor zhvilloi mbledhjen e parë, me qëllim mbajtjen e seancës dëgjimore me përmbaruesin {....} {....}, në datën 14.7.2022, ora 10:00, sipas njoftimit të sipërcituar.

3. Në datën 14.7.2022, para zhvillimit të seancës dëgjimore, në ambientet e Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, ku zhvillohej mbledhja e Komisionit Disiplinor, është paraqitur përmbaruesi gjyqësor privat {....} {....}, i cili ka paraqitur dhe dorëzuar fizikisht shkresën datë 13.7.2022, nr. {....} prot., me lëndë “Kërkesë për shtyrje të seancës dëgjimore”, të nënshkruar nga përmbaruesi {....} {....}. Përmes kësaj shkrese, përmbaruesi {....} {....} i është drejtuar Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë dhe jo Komisionit Disiplinor, që i kishte përcjellë njoftimin për t’u paraqitur në seancë dëgjimore, me një kërkesë për “shtyrjen e seancës dëgjimore e cila do të zhvillohet nesër më datë 14.7.2022, për në muajin shtator pasi do të lëviz në një vend të BE-së për një kurim më të specializuar”.

4. Shkresës i ishte bashkëlidhur raporti me nr. {....}, me nr. regjistri {....}, datë {....} “Për paaftësi të përkohshme në punë për sëmundje të përgjithshme që paguhen nga punëdhënësi”, sipas të cilit, për shtetasin “{....} {....}” dhe jo “{....} {....}”, atësia {....}, datëlindja {....}, profesioni “jurist”, për diagnozën Bronshit, jepen 3 ditë pushim, duke filluar nga data 12.7.2022 dhe duke u konsideruar i aftë për punë në datën 15.7.2022. Raporti mban vulën e mjekut të familjes pranë Qendrës Shëndetësore nr. {....}, Tiranë, {....} {....}.

5. Komisioni Disiplinor, me vendim të ndërmjetëm disponuar në mbledhjen e datës 14.7.2022, pas njohjes dhe vlerësimit të akteve si më sipër, vendosi caktimin e një date të re për zhvillimin e seancës dëgjimore, për t’i dhënë një mundësi tjetër përmbaruesit të marrë pjesë në të personalisht ose nëpërmjet një përfaqësuesi të zgjedhur prej tij, duke e riplanifikuar seancën më datë 19.7.2022.

6. Pas mbledhjes së Komisionit Disiplinor në datën 14.7.2022, ora 10:00, Kryetari i tij, me shkresën nr. {....} prot., datë 14.7.2022, me lëndë “Njoftim i përsëritur për paraqitje në seancë

dëgjimore”, njoftoi përmbaruesin {....} {....} për vendimin e ndërmjetëm për shtyrjen e seancës dëgjimore dhe riplanifikimin e saj më datë 19.7.2022. Përmes këtij njoftimi, përmbaruesi {....} {....} u njoftua edhe për faktin se, në rast të pamundësisë për t’u paraqitur personalisht para Komisionit Disiplinor, kishte të drejtë të caktonte një përfaqësues, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative dhe të nenit 77 të ligjit nr. 26/2019.

6.1 Ky njoftim iu përcoll në rrugë shkresore (shkresa nr. {....} prot., datë 14.7.2022) dhe në rrugë elektronike, në datën 14.7.2022, ora 17:35, nga adresa dhomakombetarepermbarimit@gmail.com, në adresën {....} dhe {....}, adresa zyrtare të vetëdeklaruar nga përmbaruesi gjyqësor privat {....} {....}.

6.2 Në datën 19.7.2022, ora 10:00, Komisioni Disiplinor u mbledh përsëri dhe zhvilloi një seancë dëgjimore, në të cilën përmbaruesi {....} {....} nuk u paraqit sërish. Përpara fillimit të seancës dëgjimore, në zyrat e DHKPGJP-së është paraqitur përmbaruesi z. {....} {....}, me një tjetër *“Kërkesë për shtyrje të seancës dëgjimore”* nr. {....} prot., që mbante datën 14.7.2022, nëpërmjet të cilës kërkohej shtyrja e seancës për në muajin shtator 2022. Kërkesës i ishte bashkëlidhur një *“Biletë trageti”* e prerë më datë 14.7.2022, në agjencinë *“{....}”*, sipas së cilës do të udhëtohej në datën 18.7.2022 nga {....} në {....}.

6.3 Komisioni, gjatë seancës së zhvilluar më datë 19.7.2022, diskutoi mbi këtë kërkesë të përsëritur për shtyrje të seancës dëgjimore, si dhe analizoi kërkesat e përsëritura për shtyrje seancash dhe dokumentet bashkëlidhur tyre. Përmbaruesi nëpërmjet 2 kërkesave për shtyrje seancash pretendoi se kishte arsye objektive shëndetësore *“pasi do të lëvizte në një vend të BE-së për një kurim më të specializuar”*. Përmbaruesi nuk paraqiti asnjë dokument që të justifikonte kërkesat dhe pretendimet e tij, por vetëm një biletë udhëtimi dhe një kërkesë për të shtyrë seancën dëgjimore 2 muaj më vonë.

6.4 Në këto kushte Komisionit iu krijua dyshimi se përmbaruesi, nëpërmjet kërkesave të padokumentuara, kërkonte të pengonte zhvillimin normal të procedurës disiplinore ndaj tij. Për këtë arsye, komisioni vendosi që nëpërmjet një vendimi të ndërmjetëm të ndërprejë përkohësisht seancën dëgjimore, me qëllim verifikimin zyrtar pranë institucioneve përkatëse, të pretendimeve të paraqitura prej përmbaruesit {....} {....}.

6.5 Komisioni, formalizoi një *“Kërkesë për marrje provash shtesë në kuadër të një procedimi disiplinor”*, drejtuar (1) Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Komisarariatit Nr. 2 Tiranë, nëpërmjet së cilës kërkohej të verifikohej nëse përmbaruesi {....} {....} gjendej jashtë shtetit nga data 18.7.2022 e në vijim dhe (2) Ministrisë së Drejtësisë, së cilës iu kërkua informacion nëse përmbaruesi {....} {....} kishte dërguar pranë saj, njoftim lidhur me pezullim të përkohshëm të aktivitetit përmbarimor, për shkaqe mjekësore dhe/ose shkaqe të tjera.

6.6 Komisioni, u rimbledh në datë 20.7.2022, pasi u njoftua nga administrata e Dhomës Kombëtare se ishte depozituar shkresa nr. {....} prot. datë 20.7.2022 *“Kthim përgjigje kërkesës tuaj me nr. {....} datë 19.7.2022”* të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, Komisarati i Policisë Nr. 2.

6.7 Për të administruar dokumentacionin zyrtar, Komisioni vendosi të rifillojë seancën e ndërprerë më datë 19.7.2022.

6.8 Në seancën e rifilluar më datë 20.7.2022, u paraqit edhe z. {...} {...}, i autorizuar nga Ministria Drejtësisë, i cili depozitoi para Komisionit shkresën nr. {...} prot., datë 20.7.2022 “Kthim përgjigje shkresës tuaj nr. {...}, datë 19.7.2022”.

6.9 Nga shkresat e administruara gjatë seancës dëgjimore nga të dyja autoritetet shtetërore u konfirmua se përmbaruesi gjyqësor {...} {...}: (1) Nuk kishte dalje nëpërmjet Pikave të Kalimit Kufitar të Republikës së Shqipërisë nga data 18.7.2022 e në vijim, ashtu si pretendohet nga kërkesa e tij dhe (2) Nuk kishte paraqitur asnjë njoftim zyrtar pranë Ministrisë së Drejtësisë, për pezullim të përkohshëm të aktivitetit përmbarimor, për shkaqe mjekësore.

6.10 Komisioni Disiplinor, me administrimin e këtyre shkresave zyrtare, krijoi bindjen se kërkesat e përsëritura për shtyrje të seancave dëgjimore, janë përpjekje e hapur për të penguar zhvillimin normal të procesit disiplinor nga përmbaruesi dhe në këto rrethana, vendosi vijimin e procedimit disiplinor ndaj përmbaruesit gjyqësor privat {...} {...}, në mungesë të tij.

IV. Në lidhje me pretendimet e palëve.

1. Ministria e Drejtësisë, përgjatë thirrjes së zhvillimit të dy seancave dëgjimore të Komisionit Disiplinor, dërgoi një përfaqësues në seancën e mbajtur në datë 20.7.2022, por ky i fundit nuk paraqiti asnjë argument apo element shtesë, përveç raportit të dërguar nga Ministria e Drejtësisë bashkë me dosjen hetimore.

2. Përmbaruesi gjyqësor privat {...} {...}, megjithë marrjen dijëni rregullisht për zhvillimin e dy seancave dëgjimore, nuk u paraqit në asnjërën prej tyre, as personalisht dhe as nëpërmjet një përfaqësuesi të zgjedhur prej tij, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe nuk paraqiti asnjë parashitje me shkrim.

3. Gjithashtu, konstatohet se përmbaruesi {...} {...} edhe përgjatë procesit të hetimit administrativ nga Ministria e Drejtësisë, nuk ka paraqitur dokumentet e kërkuara nga përfaqësuesit e ministrisë, pavarësisht kohës së mjaftueshme të lënë në dispozicion për depozitim të tyre dhe angazhimin për ta përmbushur këtë detyrim ligjor.

V. Në lidhje me gjetjet, konstatimet dhe shkeljet e konstatuara në urdhrin për nisjen e procedimit disiplinor dhe në raportin e Ministrisë së Drejtësisë.

Nga materiali dokumentar paraqitur nga ministri i Drejtësisë, janë ngritur disa pretendime mbi veprimtarinë e përmbaruesit {...} {...}, që lidhen me veprime të ndryshme përmbarimore të kryera prej tij, të shtrira në kohë. Konkretisht, janë referuar si shkelje sa më poshtë vijon:

A. Faktet për të cilat ministri i Drejtësisë ka urdhëruar nisjen e procedimit disiplinor përmes urdhrin nr. {...}, datë {...} “Për nisjen e hetimit disiplinor për përmbaruesin gjyqësor privat z. {...} {...}”.

1. Përmbaruesi {...} {...} nuk disponon regjistrin e çështjeve, nuk disponon aktet e lëvizjes dokumentare për kthimin e dokumentacionit palës kreditore, si dhe nuk disponon në arkiv një

njësi origjinale të praktikave përbarimore, që i ka kthyer palës kreditore për të paktën tre praktika që janë verifikuar (sipas ankesës së shtetasës {...}, ankesës së shtetasit {...} dhe shkresës me nr. {...}prot., datë {...} të “{...}Bank”).

2. Lidhur me ankesat e shtetasve {...} dhe {...} dhe shkresave nr. {...} prot., datë {...} të “{...}Bank” dhe nr. {...} prot., datë {...} të bankës “{...}”, gjatë hetimit disiplinor përbaruesi nuk ka vendosur në dispozicion të grupit të hetimit regjistrin e çështjeve, nuk ka dokumentuar kthimin e dokumentacionit palës kreditore dhe administrimin në arkivin e tij të kopjeve të njësive origjinale të dokumentacionit që ka prodhuar në përmbushje të veprimtarisë së tij përbarimore, si dhe kopje të çdo dokumenti që ka nxjerrë nga bashkëpunimi/koordinimi me institucionet përgjegjëse dhe personat fizikë dhe juridikë për qëllime të procedurës së ekzekutimit.

3. Gjithashtu, përbaruesi nuk i është përgjigjur kërkesave të përsëritura të Ministrisë së Drejtësisë për vënien në dispozicion të praktikave përbarimore sipas ankesave/shkresave të depozituara në Ministri.

4. Përbaruesi {...} {...} nuk ka mbajtur regjistrin standard të kryerjes së veprimtarisë përbarimore, në kundërshtim me nenin 37 germa “ë” të ligjit nr. 26/2019, në të cilin parashikohet se përbaruesi gjyqësor privat ka për detyrë “*të mbajë regjistrin standard të kryerjes së veprimtarisë përbarimore, si dhe të përmbushë detyrimin e trajnimit vazhdues, sipas parashikimeve të këtij ligji*”.

5. Përbaruesi {...} {...} nuk ka mbajtur në arkiv një njësi origjinale të dokumenteve që ka prodhuar në përmbushje të veprimtarisë përbarimore, në kundërshtim me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 219, datë 17.7.2020 “*Për krijimin, mbajtjen dhe administrimin e arkivit nga përbaruesi gjyqësor privat*”.

6. Përbaruesi {...} {...} nuk disponon akte të kthimit të dokumentacionit palës kreditore, për të paktën tre praktika përbarimore, në shkelje të germave “b” dhe “ç” të nenit 37 të ligjit nr. 26/2019 “*Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat*”.

7. Këto veprime janë kryer nga përbaruesi në mënyrë të përsëritur, në kundërshtim të hapur dhe flagrant me ligjin nr. 26/2019 “*Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat*” dhe urdhrin nr. 219, datë 17.7.2020 të ministrit të Drejtësisë “*Për krijimin, mbajtjen dhe administrimin e arkivit nga përbaruesi gjyqësor privat*”.

8. Nga ana e përbaruesit {...} {...}, me veprime apo mosveprime, janë kryer shkeljet disiplinore, parashikuara në pikën l, germat a), dh) dhe o) të nenit 84 të ligjit nr. 26/2019 “*Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat*”, si vijon:

a) *Shkelja në mënyrë të përsëritur e rregullave të parashikuara nga ky ligj dhe aktet nënligjore, që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë së përbaruesit gjyqësor privat dhe/ose Shkelja në mënyrë të përsëritur e detyrave të parashikuara në nenin 37 të këtij ligji;*

[...] dh) *Mosevidentimi në mënyrë të rregullt i të gjitha akteve dhe veprimeve procedurale të kryera gjatë veprimtarisë së ekzekutimit;*

[...] o) Shkelja e rregullave për krijimin, administrimin dhe ruajtjen e arkivit.

9. Gjithashtu, Ministria e Drejtësisë ka konkluduar se gjendet në zbatim të parashikimeve të pikës 2, të nenit 84 të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”, ku sanksionohet se “2. Nëse përmbartuesi gjyqësor privat kryen më shumë se një herë dhe/ose njëkohësisht dy nga shkeljet e parashikuara në shkronjat “dh”, “ë”, dhe “o” të pikës 1 të këtij neni, ai konsiderohet se ka kryer shkeljen e parashikuar në shkronjën “a”, të pikës 1 të këtij neni”.

10. Për sa më sipër, Ministria e Drejtësisë ka sjellë në vëmendje të Komisionit Disiplinor se, në referim të nenit 85, gerrat “a” dhe “b” të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat” për shkeljet e përcaktuara në nenin 84, pika 1, gerrat “a” dhe “dh”, aplikohet masa disiplinore e heqjes së licencës dhe çregjistrimit nga regjistrat, si dhe gjobë nga 50 000 deri 200 000 lekë.

Për faktet e mësipërme, të relatuara në vetë urdhrin nr. {...}, datë {...} të Ministrit të Drejtësisë, në zbatim të parashikimeve të neneve 70, 71, 84, si dhe parashikimeve të pikës 3 të nenit 85 të ligjit nr.26/2019 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”, ministri i Drejtësisë ka urdhëruar nisjen e procedimit disiplinor për përmbartuesin gjyqësor privat {...} {...}.

B. Faktet e konstatuara nga Ministria e Drejtësisë dhe të pasqyruara në raportin nr. {...} prot., datë {...} “Raport për kryerjen e hetimit disiplinor pranë përmbartuesit gjyqësor privat {...} {...}” .

1. Me shkresën me nr. {...} prot., datë {...} të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, bëhet me dije se NUIS-i {...}, që i përket përmbartuesit gjyqësor privat z. {...} {...}, ka deklaruar 0 (zero) të ardhura për periudhën 2019-2020, ndërkohë që ka rifilluar veprimtarinë përmbartimore në datë 1.9.2020. Në këto kushte, krijohet dyshimi që përmbartuesi gjyqësor privat z. {...} {...} të ketë shkelur nenin 37 germa “F” të ligjit nr. 26/2019 ku parashikohet se “Përmbartuesi gjyqësor privat ka këto detyra: të derdhë në mënyrë të rregullt detyrimet tatimore dhe profesionale” ose të jetë përpara faktit të moskryerjes së veprimtarisë përmbartimore si përmbartues gjyqësor privat, pa shkaqe të justifikuara ligjore, për më shumë se 3 muaj.
2. Me shkresën me nr. {...} prot., datë {...} të “{...}Bank”, rezulton të jetë bërë me dije fakti se, pranë kësaj banke janë administruar një sërë shkresash të përmbartuesit gjyqësor privat z. {...} {...} me nr. {...}- {...}prot., datë {...}- {...}, përmes së cilave janë dërguar një numër i konsiderueshëm urdhrash “Për vënien e sekuestros konservative”, ku në të gjithë rezulton si palë kreditore “{...}” sh.a, me objekt kthim shume. Këto urdhra rezultojnë të mos jenë ekzekutuar nga banka, pasi prej saj janë konsideruar me mangësi në aspektin formal dhe përmbajtësor, në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”.
3. Me shkresën me nr. {...} prot., datë {...} të bankës “{...}”, rezulton të jetë bërë me dije se në adresë të saj, vetëm për periudhën janar-mars 2022, janë dërguar rreth **6600 urdhra për vendosje sekuestro konservative**, për ekzekutimin e titujve ekzekutivë me palë

kreditore “{....}” sh.p.k dhe “{....}” sh.a, (të përfaqësuara nga personi juridik {....}) nga tre përmbaues gjyqësorë privatë, ndër ta edhe përmbauesi {....} {....}. Shkresat rezultojnë të dërgohen nga e njëjta adresë “Kutia Postare Nr. {....}” edhe pse mbajnë emra të ndryshëm përmbauesish.

Duke analizuar shkresat dhe ankesat e mësipërme, përmes së cilave përcillen shqetësime dhe ngrihen pretendime, në raport është vlerësuar se çojnë drejt dyshimit të arsyeshëm se, përmbauesi gjyqësor privat z. {....} {....} është duke ushtruar veprimtarinë përmbaimore në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

4. Lidhur me ankesën e shtetasit {....}{....}, në raport është evidentuar se:

4.1 Në thelb të ankesës së tij z. {....} ka pretenduar se shkresa e përmbauesit nr. {....} prot., datë {....} është përpiluar nga ky i fundit, pasi i është kërkuar informacion nga Ministria e Drejtësisë me shkresën nr. {....} prot., datë {....}.

4.2 Grupi i hetimit, duke ju referuar dosjes përmbaimore për këtë rast evidentoi se shkresa nr. {....} prot., datë {....}, sipas kronologjisë së veprimeve përmbaimore të dosjes nr. {....}, ishte regjistruar me nr. rendor {....} dhe mbante datën {....}.

4.3 Për të provuar nëse pretendimi i ankuesit ishte i vërtetë, Ministria e Drejtësisë i kërkoi informacion Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë se në cilën datë është administruar pranë DRSHTRR-së shkresa e përmbauesit me nr. {....} prot., datë {....}, urdhër “Për heqjen e sekuestros” dhe në cilin vit është bërë heqja e sekuestros.

4.4 Duke qenë së mund të kishte vonesa në përgjigje të DRSHTRR-së, si dhe nevojës për hetim disiplinor, për shkak se përmbauesi nuk dispononte regjistrat dhe lëvizjen dokumentare të disa çështjeve për të cilat ka nisur hetimi, u vlerësua e arsyeshme të vijohet me hetimin disiplinor të tij, pa pritur përgjigjen e DRSHTRR-së, duke marrë në shqyrtim ankesat e tjera si më poshtë.

5. Lidhur me ankesën e shtetasve {....} dhe {....}{....}, në raport është evidentuar se:

5.1 Grupi i hetimit, i kërkoi përmbauesit t’i vendoste në dispozicion dokumentacionin që disponon për këtë praktikë, sipas ankesës së përmendur në urdhrin e ministrit për objektin e hetimit, si dhe regjistrin në të cilin evidentohet çështja e regjistruar.

5.2 Përmbauesi është shprehur se do t’i vendosë në dispozicion në një moment të dytë, pasi regjistrat i ka në arkivë dhe për momentin nuk mund të vireshin në dispozicion.

5.3 Përmbauesit ju kërkua të vendoste në dispozicion çdo dokument që dispononte për këtë praktikë dhe **ai është shprehur se nuk ka akte të tjera dhe çdo akt i është kthyer kreditorit**. Këtë përgjigje përmbauesi e ka kthyer edhe me shkresën e tij nr. {....} prot., datë {....}. Nga përmbajtja e përgjigjes rezulton se përmbauesi ka kryer vetëm njoftimin për ekzekutim vullnetar të detyrimit, më pas është zgjidhur marrëdhënia me palën kreditore dhe më tej i ka dorëzuar kësaj të fundit dokumentacionin ligjor në bazë të nenit 46 dhe 47 të ligjit nr. 26/2019.

5.4 Në nenin 37 të ligjit nr.26/2019, germa “ë”, ndër detyrat e përmbauesit gjyqësor privat sanksionohet se përmbauesi ka detyrë “*të mbajë regjistrin standard të kryerjes së veprimtarisë përmbaimore, si dhe të përmbushë detyrimin e trajnimit vazhdues, sipas*

- parashikimeve të këtij ligji*". Nga hetimi rezultoi se përmbaruesi nuk ka dërguar kopje të regjistrit ku të evidentohen shënimet përkatëse. Ky mosveprim i përmbaruesit ngre dyshime të arsyeshme se përmbaruesi nuk e disponon këtë regjistër.
- 5.5** Gjithashtu, nuk rezultoi që përmbaruesi të ketë ndonjë akt që vërteton se dosja i është kthyer kreditorit, të jetë njoftuar debitori apo të ketë kopje të dosjes përmbarimore në administrim. Këto veprime të përmbaruesit bien në kundërshtim me gerrat "b" dhe "ç" të nenit 37 të ligjit nr. 26/2019 "*Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat*" dhe me urdhrin nr. 219, datë 17.7.2020 të ministrit të Drejtësisë.
- 5.6** Përmbaruesi nuk paraqiti asnjë korrespondencë me institucionet, asnjë dokument që vërteton lidhjen e kontratës me palën kreditore apo zgjidhjen e marrëdhënies me këtë të fundit.
- 5.7** Mungon akti i kthimit të dokumentacionit palës kreditore.
- 5.8** Pretendimi i përmbaruesit se "*nuk ka akte të procedurës përmbarimore, për shkak se çdo akt i është kthyer kreditorit*", nuk qëndron. Edhe në rastet kur i kthehet dokumentacioni palës kreditore, sipas pikës 6 të urdhrin nr. 219, datë 17.7.2020 të ministrit të Drejtësisë, "*Përmbaruesi gjyqësor privat është i detyruar të ruajë në arkiv një njësi origjinale të çdo dokumenti që prodhon në përmbushje të veprimtarisë përmbarimore, si dhe kopje të çdo dokumenti që nxirret nga institucionet përgjegjëse dhe personat fizikë dhe juridikë për qëllime të procedurës së ekzekutimit*".

Për sa më sipër, në raport është vlerësuar se ngrihen dyshime të arsyeshme që përmbaruesi ka kryer shkelje të nenit 37, gerrat "ë" dhe "ç" të ligjit nr. 26/2019 dhe pikës 6 të urdhrin nr. 219, datë 17.7.2020 të ministrit të Drejtësisë.

6. Lidhur me ankesën e shtetasës {....} {....}, në raport është evidentuar se:

- 6.1** Grupi i hetimit i kërkoi përmbaruesit t'i vendoste në dispozicion dokumentacionin që dispononte për këtë praktikë, sipas urdhrin të ministrit për objektin e hetimit, si dhe regjistrin në të cilin evidentohet çështja e regjistruar.
- 6.2** Përmbaruesi është shprehur se do t'i vendoste në dispozicion në një moment të dytë, pasi regjistrat i kishte në arkivë dhe nuk mund t'ua vinte në dispozicion për momentin.
- 6.3** Përmbaruesit iu kërkua t'i vendoste në dispozicion grupit të hetimit çdo dokument që dispononte për këtë praktikë, ndërsa ai u shpreh se çdo akt i është kthyer kreditorit dhe i qëndronte përgjigjes që kishte kthyer për Ministrinë e Drejtësisë me shkresën e tij nr. {....} prot., datë {....}.
- 6.4** Nga përmbajtja e përgjigjes rezulton se përmbaruesi ka kryer vetëm njoftimin për ekzekutim vullnetar të detyrimit, më pas është zgjidhur marrëdhënia me palën kreditore, ka më tej përmbaruesi i ka dorëzuar dokumentet palës kreditore, duke i kthyer kësaj të fundit dokumentacionin ligjor në bazë të neneve 46 dhe 47 të ligjit nr. 26/2019. Përmbaruesi nuk është në dijeni të trajtimit të mëtejshëm të praktikës nga pala kreditore dhe/ose përfaqësuesi i saj {....}.
- 6.5** Nga hetimi rezultoi se përmbaruesi nuk ka dërguar kopje të regjistrit ku të evidentohen shënimet përkatëse. Ky mosveprim i përmbaruesit ngre dyshime të arsyeshme se përmbaruesi nuk e disponon këtë regjistër. Gjithashtu, nuk rezultoi që përmbaruesi të kishte ndonjë akt që vërteton se dosja i është kthyer kreditorit apo të ketë kopje të dosjes

përmbareme në administrim. Kjo praktikë e përmbaremit bie në kundërshtim me urdhrin nr. 219, datë 17.7.2020 të ministrit të Drejtësisë.

- 6.6** Përmbaremi nuk paraqiti asnjë korrespondencë me institucionet, si dhe asnjë dokument që vërteton lidhjen e kontratës me palën kreditore apo zgjidhjen e marrëdhënies me këtë të fundit.
- 6.7** Mungon akti i kthimit të dokumentacionit palës kreditore. Edhe në rastet kur i kthehet dokumentacioni palës kreditore, sipas pikës 6 të urdhrin nr. 219, datë 17.7.2020 të ministrit të Drejtësisë, *“Përmbaremi gjyqësor privat është i detyruar të ruajë në arkiv një njësi origjinale të çdo dokumenti që prodhon në përmbushje të veprimtarisë përmbareme, si dhe kopje të çdo dokumenti që nxirret nga institucionet përgjegjëse dhe personat fizikë dhe juridikë për qëllime të procedurës së ekzekutimit”*.
- 6.8** Përmbaremi nuk disponon regjistrin e çështjeve sipas germës “ë” të nenit 37 të ligjit nr. 26/2019 dhe ngrihen dyshime të arsyeshme se ai nuk ka në administrim kopje të praktikës përmbareme, sipas pikës 6 të urdhrin nr. 219, datë 17.7.2020 të ministrit të Drejtësisë.

Sa më sipër, në raport është evidentuar se, ngrihen dyshime të arsyeshme se përmbaremi ka kryer shkelje të pikës 6 të urdhrin nr. 219, datë 17.7.2020 të ministrit të Drejtësisë, e cila i korrespondon shkeljes së nenit 37, germa “b” të ligjit nr. 26/2019 ku përcaktohet detyra e përmbaremit *“b) të zbatojë me përpikëri dispozitat e Kodit të Procedurës Civile dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore”*.

- 7.** Lidhur me shkresën me nr. {...} **prot., datë** {...} *“Lajmërim për ekzekutim vullnetar të detyrimit”*.

7.1 Kjo shkresë përmban nënshkrimin dhe vulën e përmbaremit z. {...} {...}, për të cilën ngrihen dyshime se ka të meta, si në aspektin formal, ashtu dhe në atë përmbajtësor, referuar pretendimeve të ankuesve, si dhe parashikimeve të ligjit nr. 26/2019 dhe Kodit të Procedurës Civile.

7.2 Lidhur me këtë pretendim, grupi i hetimit i kërkoi përmbaremit t’i vinte në dispozicion dokumentacionin që disponon për këtë praktikë, sipas urdhrin të ministrit për objektin e hetimit.

7.3 Edhe në këtë rast, përmbaremi mbajti qëndrimin se çdo akt i është kthyer kreditorit dhe nuk vuri në dispozicion asnjë dokument. Mosdërgimi i këtij dokumentacioni ngriti dyshimin e arsyeshëm se përmbaremi nuk i dispononte këto dokumente dhe në referim të nenit 84 pika I, germa “dh” të ligjit nr.26/2019, në raport është konsideruar ky fakt si *“mosevidentimi në mënyrë të rregullt i të gjitha akteve dhe veprimeve procedurale të kryera gjatë veprimtarisë së ekzekutimit”*.

- 8.** Lidhur me përdorimin e kutisë postare me nr. {...} dhe shkresat nr. {...}, nr. {...}, nr. {...} dhe nr. {...}.

8.1 Grupi i hetimit i kërkoi përmbaremit t’i vinte në dispozicion shkresat e sipërpërmendura dhe regjistrin në të cilin janë evidentuar shkresat dhe praktika. Përmbaremi është shprehur se shkresat e kërkuara do t’i vendoste në dispozicion në një moment të dytë, bashkë me regjistrat.

8.2 Grupi i hetimit, më datë 4.5.2022, i la detyrë përmbauesit të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar, brenda datës 9.5.2022.

8.3 Nga komunikimi me sektorin e protokoll arkivit, u konfirmua se në Ministrinë e Drejtësisë nuk ishin administruar shkresa, kërkesa apo kthim përgjigje, të cilat të ishin dërguar nga përmbauesi {...} {...}.

8.4 Për sa më sipër, mosdërgimi i informacionit të kërkuar, sipas raportit, ngriti dyshime të arsyeshme se përmbauesi nuk e dispononte dokumentacionin dhe në referim të nenit 84 pika 1, germa “dh” të ligjit nr. 26/2019, do të konsiderohej si *“mosevidentimi në mënyrë të rregullt i të gjitha akteve dhe veprimeve procedurale të kryera gjatë veprimtarisë së ekzekutimit”*.

9. Përmes shkresës nr. {...} prot., datë {...} të “{...}Bank”, bëhet me dije se, pranë kësaj banke janë administruar një sërë shkresash të përmbauesit gjyqësor privat {...} {...}, përmes së cilave janë dërguar një numër i konsiderueshëm urdhrash *“Për vënien e sekuestros konservative”*, ku në të gjithë urdhrat rezulton si palë kreditore “{...}” sh.a, me objekt kthim shume. Këto urdhra rezultojnë të mos jenë ekzekutuar nga banka, pasi prej saj janë konsideruar me mangësi në aspektin formal dhe përmbajtësor, në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 26/2019 *“Për shërbimin përmbauesor gjyqësor privat”*.

9.1 Grupi i hetimit, i kërkoi përmbauesit t’i vinte në dispozicion shkresat që lidheshin me palën kreditore “{...}” sh.a dhe regjistrin në të cilin janë evidentuar të regjistruara praktikat, ndërsa përmbauesi edhe këtë herë është shprehur se regjistri do të vihej në dispozicion në një moment të dytë, ndërsa për shkresat që janë hartuar për këtë praktikë bëri me dije se i janë kthyer kreditorit me kërkesën e tij. Këto shkresa nuk u administruan nga Ministria e Drejtësisë, pasi përmbauesi nuk i vuri në dispozicion, pavarësisht afateve të vazhdueshme të lëna për këtë qëllim.

9.2 Përmbauesi nuk paraqiti asnjë korrespondencë me institucionet, asnjë dokument që vërteton lidhjen e kontratës me palën kreditore apo zgjidhjen e marrëdhënies me këtë të fundit.

9.3 Mungon akti i kthimit të dokumentacionit palës kreditore dhe njoftimi i palës debitore.

9.4 Pretendimi i përmbauesit se *“nuk ka akte të procedurës përmbauesore, për shkak se çdo akt i është kthyer kreditorit”*, nuk qëndron. Edhe në rastet kur i kthehet dokumentacioni palës kreditore, sipas pikës 6 të urdhrin nr. 219, datë 17.7.2020 të ministrit të Drejtësisë, *“Përmbauesi gjyqësor privat është i detyruar të ruajë në arkiv një njësi origjinale të çdo dokumenti që prodhon në përmbushje të veprimtarisë përmbauesore, si dhe kopje të çdo dokumenti që nxirret nga institucionet përgjegjëse dhe personat fizikë dhe juridikë për qëllime të procedurës së ekzekutimit”*.

10. Lidhur me mosdeklarimin e të ardhurave nga përmbauesi për periudhën 2019-2020.

10.1 Grupi i hetimit i kërkoi përmbauesit t’i vinte në dispozicion çdo deklaram që ka bërë pranë tatimeve, ndërsa ai është shprehur se nuk ka dokumente momentalisht dhe se do shprehej zyrtarisht në një moment të dytë, pasi të marrë informacion nga ekonomisti.

10.2 Grupi i hetimit më datë 4.5.2022 i ka lënë detyrë përmbauesit të dorëzojë dokumentacionin për këtë pretendim brenda datës 9.5.2022, dokumentacion që nuk u vu në dispozicion prej tij.

11. Lidhur me shkresën me nr. {...}prot., datë {...} të bankës “{...}”.

11.1 Me shkresën me nr. {...} prot., datë {...}, banka “{...}” informon se në adresë të saj, vetëm për periudhën janar-mars 2022, janë dërguar **rreth 6600 urdhra për vendosje sekuestro konservative**, për ekzekutimin e titujve ekzekutivë me palë kreditore “{...}” sh.p.k dhe “{...}” sh.a, (të përfaqësuara nga personi juridik {...}) nga tre përmbaues gjyqësorë privatë, ndër ta edhe përmbauesi {...} {...}.

11.2 Shkresat rezultojnë të jenë dërguar nga e njëjta adresë, “Kutia Postare Nr. {...}”, edhe pse mbajnë emra të ndryshëm përmbauesish.

11.3 Grupi i hetimit, i kërkoi përmbauesit t’i vendoste në dispozicion shkresat që lidhen me palën kreditore “{...}” sh.a dhe regjistrin në të cilin janë evidentuar të regjistruara praktikant, ndërsa përmbauesi edhe për këtë kërkesë është shprehur se regjistri do vihej në dispozicion në një moment të dytë, ndërsa për shkresat që janë hartuar për këtë praktikë, bëri me dije se i janë kthyer kreditorit me kërkesën e tij.

11.4 Grupi i hetimit më datë 4.5.2022, në mënyrë të përsëritur, i la detyrë përmbauesit të dorëzonte dokumentacionin për këtë pretendim, brenda datës 9.5.2022 e megjithatë, ky dokumentacion nuk u dorëzua.

11.5 Përmbauesi nuk paraqiti asnjë korrespondencë me institucionet, asnjë dokument që vërteton lidhjen e kontratës me palën kreditore apo zgjidhjen e marrëdhënies me këtë të fundit.

11.6 Mungon akti i kthimit të dokumentacionit palës kreditore.

11.7 Pretendimi i përmbauesit *“se nuk akte të procedurës përmbaimore, për shkak se çdo akt i është kthyer kreditorit”*, është vlerësuar edhe në këtë rast se nuk qëndron, pasi në rastet kur i kthehet dokumentacioni palës kreditore, sipas pikës 6 të urdhrit nr. 219, datë 17.7.2020 të ministrit të Drejtësisë, *“Përmbauesi gjyqësor privat është i detyruar të ruajë në arkiv një njësi origjinale të çdo dokumenti që prodhon në përmbushje të veprimtarisë përmbaimore, si dhe kopje të çdo dokumenti që nxirret nga institucionet përgjegjëse dhe personat fizikë dhe juridikë për qëllime të procedurës së ekzekutimit”*.

12. Përdorimi i kutisë postare nr. {...}, si adresë e ndryshme nga ajo e deklaruar pranë Ministrisë së Drejtësisë.

12.1 Në raport është evidentuar se, referuar nenit 23 pika l, germa “dh” të ligjit nr. 26/2019 përcaktohet se: *“Regjistri i përmbauesve gjyqësorë privatë krijohet pranë ministrisë. Ky regjistër ruhet, mirëmbahet dhe përditësohet në format të integruar manual dhe elektronik nga strukturat përgjegjëse të ministrisë. Ky regjistër përmban të dhënat publike si vijon: adresa e vendit, ku zhvillon veprimtarinë përmbaimore”*.

12.2 Përmbauesi ka deklaruar adresën e vendit ku ushtron veprimtarinë përmbaimore në adresën: Rruga “{...}”, Pallati {...}, kati {...}, Nr. {...}, 1001, Tiranë.

12.3 Përdorimi i kutisë postare nga përmbauesi është arsyetuar si një formë lehtësie në komunikim me palët debitore.

12.4 Përdorimi i kutisë postare në vetvete njihet nga KPA dhe kjo nuk konsiderohet ushtrim i aktivitetit përbarimor në adresa të ndryshme nga ato të deklaruara nga përbaruesi.

Në përfundim të vlerësimit të materialit objekt hetimi administrativ, grupi i kontrollit, nëpërmjet raportit të përcjellë pranë Komisionit Disiplinor ka ngritur dyshime të arsyeshme se nga ana e përbaruesit, me veprime apo mosveprime, janë kryer shkeljet disiplinore, të parashikuara në pikën 1, germat a), dh), dhe o) të nenit 84 të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat”, si vijon:

- shkelja në mënyrë të përsëritur e rregullave të parashikuara nga ky ligj dhe aktet nënligjore, që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë së përbaruesit gjyqësor privat dhe/ose shkelja në mënyrë të përsëritur e detyrave të parashikuara në nenin 37 të këtij ligji;
- mosevidentimi në mënyrë të rregullt i të gjitha akteve dhe veprimeve procedurale të kryera gjatë veprimtarisë së ekzekutimit;
- shkelja e rregullave për krijimin, administrimin dhe ruajtjen e arkivit.

Gjithashtu, grupi i kontrollit ka konkluduar se gjenden në zbatim të parashikimeve të pikës 2 të nenit 84 të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat”, ku sanksionohet se nëse përbaruesi gjyqësor privat kryen më shumë se një herë dhe/ose njëkohësisht dy nga shkeljet e parashikuara në germat “d”, “dh”, “e”, “ë”, “g”, “i”, “k”, “l”, “ll”, “m , nj” dhe “o” të pikës 1 të këtij neni, ai konsiderohet se ka konsumuar shkeljen e parashikuar në germën “a” të pikës 1 të këtij neni.

Bazuar në shkeljet e sipërpërmendura, grupi i kontrollit ka rekomanduar:

- fillimin e procedimit disiplinor, duke paraqitur në Komisionin Disiplinor raportin e hetimit së bashku me dosjen hetimore;
- heqjen e licencës dhe çregjistrimin nga regjistrat;
- propozimin e masës disiplinore “Gjobë nga 50 000 deri 200 000 lekë”.

VI. Vlerësimi i Komisionit Disiplinor mbi faktet e paraqitura, mbi dokumentacionin dhe informacionin e administruar dhe analiza e tyre.

1. Komisioni Disiplinor, së pari vlerësoi nëse në referimin e rasteve, ministri i Drejtësisë kishte respektuar parashikimin e nenit 85, pika 2 të ligjit nr. 26/2019, që përcakton se:

“2. Masat disiplinore jepen brenda 6 muajve nga data e konstatimit të shkeljes, por jo më vonë se 2 vjet nga çasti i kryerjes së saj. Në këtë rast parashkrimi i masës fillon pas afateve të përcaktuara”.

Nisur nga dokumentacioni i administruar, Komisioni vlerësoi se nuk është në rastet e pengesës për të vijuar, sipas përcaktimit të dispozitës së sipërcituar.

2. Mbi pretendimin e përbaruesit {....} {....} për shtyrjen e përsëritur të seancave dëgjimore, Komisioni Disiplinor vlerësoi se duhet të vazhdojë procesin disiplinor dhe të mos krijojë më një mundësi të tretë, për përsëritjen dhe shtyrjen e seancave dëgjimore, pa shkaqe të justifikuara, pasi përbaruesi {....} {....} nuk u paraqit në asnjë rast dhe nuk shfrytëzoi asnjë nga dy seancat dëgjimore të thirrura nga Komisioni, megjithëse kishte dijeni rregullisht.

2.1 Përmbaruesit {...} {...} iu bë me dije mundësia ligjore për t'u përfaqësuar, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative, por nuk e shfrytëzoi në të dy rastet këtë mundësi, si dhe nuk paraqiti asnjë parashtrësë me shkrim, përveç pretendimeve për shtyrjen e seancave, për shkak të pamundësisë shëndetësore.

2.2 Përmbaruesi {...} {...} u konfirmua se raportoi pretendime të pajustificuara kur paraqiti nëpërmjet depozitimit shkresor para Komisionit, një herë raport mjekësor 3-ditor, për sëmundje që mjeku i familjes i kategorizonte *“Paaftësi të përkohshme në punë për sëmundje të përgjithshme që paguhen nga punëdhënësi”* dhe një *“Biletë tragei”* të prerë më datë 14.7.2022, ku tregohet se do të udhëtonte në datën 18.7.2022 nga {...} në {...}, por të pashoqëruar me asnjë dokument mjekësor, që do të mund të provonte arsyen e udhëtimit dhe për më tepër, u verifikua nga Komisioni se nuk e kishte realizuar dhe as njoftuar Ministrinë e Drejtësisë lidhur me pezullim të përkohshëm të aktivitetit përmbarimor, për shkaqe të pretenduara mjekësore dhe/ose shkaqe të tjera objektive që lidhen me to.

2.3 Përmbaruesi {...} {...}, vlerësohet nga Komisioni se ka kryer për mëse dy herë, veprime të qëllimshme për t'iu shmangur pjesëmarrjes në seancat dëgjimore lidhur me këtë procedim disiplinor dhe fakti që nuk ka shfrytëzuar në asnjë rast mundësinë e përsëritur për t'u paraqitur personalisht në dy seancat dëgjimore, mundësinë e përfaqësimit të tij ligjor, si dhe mundësinë e depozitimit të parashtrimeve me shkrim lidhur me këtë procedim disiplinor, përbën shkak që bind Komisionin për analizimin, vlerësimin dhe vendimmarrjen mbështetur direkt në dokumentacionin dhe Raportin e paraqitur nga Ministria e Drejtësisë.

2.4 Komisioni Disiplinor i konsideron pretendimet e përmbaruesit {...} {...} për shtyrjen e seancave dëgjimore të pabazuara dhe me artifica të qëllimshme, për të zvarritur procesin disiplinor bashkë me vendimmarrjen e Komisionit.

3. Lidhur me faktet e konstatuara nga Ministria e Drejtësisë, dokumentacionin e administruar, shkresat dhe informacionin e pasqyruar në raportin nr. {...} prot., datë {...} *“Raport për kryerjen e hetimit disiplinor pranë përmbaruesit gjyqësor privat {...} {...}”* nga Komisioni Disiplinor evidentohen gjetje të përbashkëta, si në aspektin e ankesave të veçanta, si ato shtetasve {...} dhe {...}{...}apo {...}{...}, ashtu dhe në tipologjinë e përdorimit dhe aplikimit të standardit të njëjtë, në lëshimin e akteve procedurale, si shkresa nr. {...} prot., datë {...} *“Lajmërim për ekzekutim vullnetar të detyrimit”*.

3.1 Nga aktet e administruara, Komisioni konstaton se përmbaruesi {...} {...}:

- **Nuk ka paraqitur** një Regjistër për Çështjet Përmbarimore, ku duhet të jenë të regjistruara të gjitha kërkesat për vënie në ekzekutim;
- **Nuk ka paraqitur** një arkivë përmbarimore ku të evidentohen dosjet/çështjet objekt ankesash, objekt i hetimit disiplinor të iniciuar nga Ministria e Drejtësisë dhe objekt i këtij procedimi disiplinor;
- **Nuk ka paraqitur** asnjë korrespondencë me institucionet, asnjë dokument ligjor dhe/ose financiar që vërteton lidhjen e kontratave të shërbimit me palët kreditore apo zgjidhjen e marrëdhënies me to; *dhe*

- **Ka pretenduar** se çdo dosje që lidhet me çështjet përmbareme në ekzekutim i është kthyer kreditorit dhe nuk ka mbajtur të administruar asnjë dokumentacion ligjor lidhur me to.

Të gjithë përmbareuesit gjyqësorë privatë, që ushtrojnë aktivitet, duhet të jenë të pajisur me Regjistrin (manual) e Çështjeve Përmbareme. Përmbareuesit kryejnë regjistrimin e të gjitha çështjeve përmbareme të administruara për ekzekutim në Regjistrin e Çështjeve Përmbareme, ku duhet të pasqyrojnë në mënyrë të plotë të dhënat që kërkon ky dokument. Mungesa e këtij dokumenti, përkon me shkelje të detyrimeve ligjore të përmbareuesit, sipas parashikimeve të germës “ë”) të nenit 37 të ligjit 16/2019 “Për shërbimin përmbareme gjyqësor privat”.

Përmbareuesi gjyqësor privat detyrohet të ruajë dhe administrojë arkivin e krijuar prej tij gjatë ushtrimit të veprimtarisë përmbareme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për arkivat, si dhe rregullat e parashikuara në urdhrin **nr. 220, datë 17.7.2020** të ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e formularit të ankesave për përmbareuesit gjyqësorë privatë”.

Përmbareuesi e mban gjithnjë arkivin e tij në zyrën ku ushtron veprimtarinë përmbareme dhe në asnjë rast nuk mund të pretendojë se “nuk e ka”. Arkivi i përmbareuesit gjyqësor privat përmban regjistrat e regjistrimit të çështjeve përmbareme dhe çdo dokument që lidhet me korrespondencën e përmbareuesit gjyqësor privat me institucionet përgjegjëse dhe personat fizikë dhe juridikë, prodhuar për qëllim të procedurës së ekzekutimit.

Përmbareuesi gjyqësor privat është i detyruar të ruajë në arkiv një njësi origjinale të çdo dokumenti që prodhon në përmbushje të veprimtarisë përmbareme, si dhe kopje të çdo dokumenti që nxirret nga institucionet përgjegjëse dhe personat fizikë dhe juridikë për qëllime të procedurës së ekzekutimit.

Mungesa e arkivit të përmbareuesit {...} {...} dhe për më tepër fakti i konstatuar se nuk posedon apo disponon asnjë dokument të dosjeve/çështjeve përmbareme në ekzekutim, **sipas pretendimit** se “çdo dosje që lidhet me çështjet përmbareme në ekzekutim i është kthyer kreditorit dhe nuk ka mbajtur të administruar asnjë dokumentacion ligjor lidhur me to”, adreson një veprimtari në shkelje të hapur të akteve nënligjore në fuqi, konkretisht të **urdhrit nr. 219, datë 17.7.2020**, të ministrit të Drejtësisë “Për krijimin, mbajtjen dhe administrimin e arkivit nga përmbareuesi gjyqësor privat”.

Mungesa e kontratës së shërbimit tregon se, marrëdhëniet ndërmjet përmbareuesit {...} {...} dhe kreditorit, për rastet e analizuara sipas dokumentacionit të administruar, nuk janë rregulluar nëpërmjet kontratës së shërbimit, bazuar në nenin 45 të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbareme gjyqësor privat”.

Duhet theksuar se, kontrata e shërbimit nuk është vetëm një e drejtë, por edhe një detyrim ligjor i përmbareuesit gjyqësor privat, që rrjedh nga parashikimi i ligjvënësit për të ngarkuar ministrin e Drejtësisë për të rregulluar këtë marrëdhënie me akt nënligjor.

Urdhri nr. 4321/4, datë 18.7.2017 i ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e modelit të kontratës që lidhet midis shoqërisë përmbareme/përmbareuesit gjyqësor privat dhe palës së interesuar

përpara fillimit të procedurave të ekzekutimit”, tregon qartë kohën kur linden marrëdhëniet ndërmjet përmbauesit gjyqësor privat dhe palës së interesuar. Kontrata e shërbimit, lidhet gjithmonë para fillimit të procedurës së ekzekutimit të detyruar, detyrim që, nëse nuk përmbushet përbën shkelje dhe shkak direkt për nisjen e hetimit disiplinor ndaj një përmbauesi gjyqësor privat.

Në rastin konkret, përmbauesi {....} {....} nuk disponon asnjë dokument të dosjeve përmbaimore dhe për pasojë, asnjë kontratë shërbimi, fakt që evidenton edhe moskryerjen e pagesave të tarifës përmbaimore, në përmbushje të detyrimit ligjor të parashikuar në nenet 515 dhe 525 të Kodit të Procedurës Civile.

Referuar shkresës me nr. {....} prot., datë {....} të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, e cila tregon se, NUIS-i {....}, që i përket përmbauesit gjyqësor privat z. {....} {....}, ka deklaruar 0 (zero) të ardhura për periudhën 2019-2020, ndërkohë që ka rifilluar veprimtarinë përmbaimore në datë 1.9.2020, evidenton një fakt tjetër, pasi tregon se, përmbauesi gjyqësor privat, z. {....} {....}, nuk ka derdhur në mënyrë të rregullt detyrimet tatimore dhe profesionale për një kohë relativisht të gjatë, në shkelje të nenit 37 germa “f” të ligjit nr. 26/2019 dhe/ose adreson një fakt tjetër, atë të moskryerjes së veprimtarisë përmbaimore si përmbaues gjyqësor privat, pa shkaqe të justifikuara ligjore, për më shumë se 3 muaj. Nëse nga Ministria e Drejtësisë do të konstatohej se përmbauesi nuk ka kryer veprimtari përmbaimore si përmbaues gjyqësor privat, pa shkaqe të justifikuara ligjore, për më shumë se 3 (tre) muaj dhe nëse vërtetohej ky fakt, atëherë do të ishim në kushtet kur përmbauesit {....} {....} do të duhej t’i ishte hequr licenca dhe të çregjistrohej nga regjistri i profesionit të përmbauesit gjyqësor privat, bazuar në nenin 28, germa “f” të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbaimor gjyqësor privat”.

Deklarimi në shkresat zyrtare-procedurale nga përmbauesi {....} {....} të adresës për komunikimet zyrtare: **Kutia Postare Nr. {....} Tiranë** bie në kundërshtim flagrant me mënyrat e njoftimit dhe respektimit të normave procedurale të sanksionuara në nenet 517 dhe 129 të Kodit të Procedurës Civile.

Mosdeklarimi i adresës së përmbauesit {....} {....} sipas kërkesave standarde të treguara në nenin 23 të ligjit nr. 26/2019, në të cilin parashikohet “*Regjistri i Përmbauesve Gjyqësorë Privatë dhe Regjistri Unik i të dhënave për zyrat përmbaimore dhe përmbauesit gjyqësorë privatë*”, automatikisht ka krijuar një premisë për të kufizuar të drejtën e kontrollit gjyqësor të të gjithë debitorëve, që mund të kenë dashur të kundërshtojnë pasojat e akteve përmbaimore e që kanë sjellë pasoja direkte, pasi nuk janë njoftuar.

Deklarimi si adresë për komunikimet zyrtare, **Kutia Postare Nr. {....} Tiranë**, është në kundërshtim flagrant me paragrafin e fundit të nenit 517 dhe nenin 129 të Kodit të Procedurës Civile, që respektivisht parashikojnë:

- “[...] **Përmbauesi gjyqësor kryen lajmërimet dhe njoftimet, duke zbatuar parashikimet e pjesës I, titulli VI, kreu IV, “Njoftimet”, të këtij Kodi [...]**”

- “[...] **Thirrja në gjykatë bëhet nëpërmjet njoftimit të letërthirrjes, e cila duhet të përmbajë gjykatën që e ka nxjerrë, emrin, mbiemrin e personit të thirrur, kohën e vendin e seancës gjyqësore, mosmarrëveshjen për të cilën thirret, kohën e njoftimit të aktit, si dhe pasojat ligjore në rast se personi i thirrur nuk paraqitet në gjykatë [...]**”.

Meqenëse në aktet përbarimore te konstatuara nuk pasqyrohet adresa zyrtare e përbaruesit {....} {....}, atëherë këto akte paraqesin mangësi thelbësore për sa i përket mënyrës së njoftimit dhe respektimit të normave procedurale të sanksionuara në nenet 517 dhe 129 të Kodit të Procedurës Civile.

Mosdeklarimi i saktë i adresës apo dublimi i saj, i ka kufizuar të drejtën e kontrollit gjyqësor të gjithë debitorëve të prekur nga këto shkresa, për të kundërshtuar procedurat e ekzekutimit të treguara sipas akteve të veçanta të lëshuara në emër të tyre, ndaj dhe në këto kushte vlerësohet se, **përbaruesi {....} {....} ka shkelur në mënyrë të përsëritur nenet 517 dhe 129 të Kodit të Procedurës Civile dhe për pasojë, nenin 37, germa “b)” të ligjit nr. 26/2019.**

Për më tepër, në shkresën nr. 243/1, datë 4.2.2022 të Postës Shqiptare, “*Dhënie Informacioni*” konstatohet se, Kutia Postare Nr. {....}Tiranë, nuk i përket përbaruesit {....} {....}, por shoqërisë tregtare “{....}” sh.p.k., fakt ky që tregon se përbaruesi {....} {....} është përfshirë në praktika të ndaluara, duke përdorur metoda të pandershme në mbledhjen e detyrimeve, në kundërshtim me dispozitat ligjore ne fuqi.

Bazuar në nenin 38, të ligjit nr. 26/2019, përbaruesi gjyqësor privat gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, nuk duhet të kryejë veprime që cenojnë apo abuzojnë me subjektet, që u nënshtrohen procedurave të ekzekutimit dhe u ndalohej veçanërisht kryerja e veprimtarive të mëposhtme:

- “[...] ç) angazhimi në ndonjë praktikë të ndaluar, ose përdorimi i ndonjë metode të pandershme në mbledhjen e detyrimeve, në kundërshtim me dispozitat ligjore;*
- d) çdo veprim tjetër me karakter mashtrues, i cili do të komprometonte rëndë besimin e palëve dhe integritetin moral të përbaruesit gjyqësor privat;*
- dh) angazhimi nga përbaruesi gjyqësor privat, i personave të tjerë të palicencuar dhe të cilët nuk parashikohen nga ky ligj për kryerjen e veprimtarisë përbarimore”.*

Përgjatë kësaj analize, shkresat e administruara nga aktiviteti i përbaruesit {....} {....}, të gjitha adresojnë shënimin “Kutia Postare Nr. {....}Tiranë” dhe për pasojë referojnë kryerjen e praktikave të ndaluara sipas nenit 38 të ligjit nr. 26/2019.

Evidentimi i këtij fakti është i mjaftueshëm dhe tepër i rëndë nëse do të konsiderohej lidhur me të dhënat e evidentuara në shkresën me nr. {....} prot., datë {....} të bankës “{....}” e cila informon se në adresë të saj, vetëm për periudhën janar-mars 2022, janë dërguar rreth 6600 urdhra për vendosje sekuestro konservative, për ekzekutimin e titujve ekzekutiv me palë kreditore “{....}” sh.p.k dhe “{....}” sh.a, (të përfaqësuara nga personi juridik {....}) nga tre përbarues gjyqësorë privatë, ndër ta edhe përbaruesi {....} {....}. Shkresat rezultojnë të dërgohen nga e njëjta adresë, “Kutia Postare Nr. {....}” edhe pse përmbajnë emra të ndryshëm përbaruesish.

Nga analiza e shkresave procedurale të lëshuara nga përbaruesi {....} {....}, evidentohet gjithashtu se ato kanë tipologji dhe përmbajtje të njëjtë, sa i përket vënies në dijeni të përfaqësuesit të kreditorit: “Institucioni financiar “{....}”, që ka zgjedhur të përfaqësohet nga subjekti juridik {....}sh.p.k. me NUIS {....}” dhe se këto shkresa/akte, kanë tipologji të njëjtë sa i përket mungesës së emërtimit të subjektit përbarimor si “zyrë përbarimi privat”, sipas kërkesave të ligjit nr.

26/2019, ku evidentohen kredenciale vetëm në formën e emër mbiemrit të {...} {...}, me vulë dhe nënshkrim teknikisht, apo formalisht të njëjtë.

Bazuar në nenin 88 pika 8, të ligjit nr. 26/2019 të gjithë përmbaruesit gjyqësorë privatë ngarkoheshin dhe detyroheshin të ndryshonin emërtimin e shoqërive përmbarimore private në “zyrë e përmbarimit privat”, duke regjistruar këtë ndryshim në Qendrën Kombëtare të Biznesit, brenda muajit Nëntor 2019. Mospërbushja e këtij detyrimi, përbën shkelje disiplinore, fakt që ngarkon me përgjegjësi përmbaruesin gjyqësor privat {...} {...} për të gjitha shkresat procedurale të konstatuara nga ana formale, në këtë proces disiplinor.

VII. Konkluzionet e procesit disiplinor.

Pas kësaj analize ligjore në kuadër të kryerjes së plotë të hetimit administrativ ndaj veprimtarisë së përmbaruesit – objekt i këtij procesit disiplinor, në referim të kërkesës së ministrit të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj përmbaruesit gjyqësor privat {...} {...}, Komisioni Disiplinor arrin në konkluzionin dhe vendimmarrjen vijuese.

Nga analiza e plotë e dokumenteve, fakteve dhe provave të administruara në këtë proces administrativ, në përfundim të procesit disiplinor zhvilluar ndaj përmbaruesit gjyqësor privat {...} {...}, në zbatim të nenit 80, pika 2, germa “b”, pika 3, të nenit 81, germa “b” dhe bazuar në nenet 84, 85, 86 të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, Komisioni Disiplinor,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së ministrit të Drejtësisë për marrjen e masave disiplinore ndaj përmbaruesit gjyqësor privat {...} {...}.
2. Marrjen e masës disiplinore të heqjes së licencës dhe çregjistrimin nga regjistrat të përmbaruesit gjyqësor privat {...} {...}.
3. Njoftimin e këtij vendimi ministrit të Drejtësisë, për kryerjen e ekzekutimit të këtij vendimi brenda dy javëve nga njoftimi i tij dhe zbatimin e kësaj mase disiplinore duke njoftuar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, për çregjistrimin nga regjistri tregtar të subjektit me NUIS {...}, që i përket përmbaruesit gjyqësor privat z. {...} {...} dhe njoftimin e të gjitha institucioneve shtetërore dhe autoriteteve publike e private lidhur me këtë vendim.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ndaj tij mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
5. Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë të marrë menjëherë masa për njoftimin e këtij vendimi pranë Ministrisë së Drejtësisë.

Anëtar

Erind MËRKURI

Anëtar

Tedi MALAVECI

Kryetar

Vangjel KOSTA